



VENDIM RRETH KËRKESËS PËR RISHQYRTIM

Data e miratimit: 7 prill 2014

Numri i lëndës: 2013-04

J.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 prill 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin e Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 10 qershor 2013. Ankuesja ka kërkuar që emri i saj mos të bëhet publik. Paneli ka miratuar kërkesën e saj.
2. Më 4 shkurt 2014, Paneli ka gjetur ankesën të papranueshme. Paneli ka gjetur se nuk kishte kompetenca për të shqyrtuar ankesat në lidhje me gabimet e pretenduara nga ana e gjykatave të Kosovës dhe

procedurave të tejzgjatura, pasi këto kanë dalë jashtë kompetencave të tij sipas nenit 29 (d) të rregullores së punës.

3. Më 3 mars 2014, ankuesja ka kërkuar rishqyrtimin e ankesës së saj sipas rregullit 42 të rregullores së punës së Panelit.

IV. LIGJI

Kërkesa për rishqyrtim

4. Ankuesja ka kërkuar nga Paneli që ta rishqyrtoj vendimin e vet të datës 4 shkurt 2014. Ajo ka argumentuar se Paneli ka keqkuptuar parashtrimet e saja dhe nuk kishte shqyrtuar ankesën e saj në lidhje me humbjen e një dokumenti të rëndësishëm gjatë procedurave lidhur me pronën e saj nga gjykatat e Kosovës. Ajo ka dorëzuar dokumentin në fjalë, pra autorizimin që autorizon atë ta përfaqësoj vëllain e vet gjatë procedurave.
5. Paneli konstaton se procedura për rishqyrtim, e cila parashihet në rregullën 42, ka për qëllim të ofrojë një mekanizëm procedural ku parashtruesi i ankesës mund të kërkojë rishqyrtimin e një vendimi të papranueshmërisë vetëm atëherë kur një fakt i ri, të cilin ai ose ajo nuk ka mundur ta dijë me arsye në kohën e ankesës së parë do të kishte pasur një ndikim vendimtar në konstatimet e Panelit (shih *Y kundër EULEX-it* (ri-shqyrtim, nr. 2011-28, paragrafët 7-8).
6. Në këtë rast, ankuesja nuk ka paraqitur asnjë dëshmi të re, pasi dokumentet e parashtruara nga ankuesja ishin dërguar prej saj së bashku me ankesën e saj fillestare. Ajo thjesht nuk është dakord me cilësimin e ankesës së saj nga ana e Paneli si dhe të vendimin e tij. Dokumentet që i janë bashkëngjitur kërkesës janë shqyrtuar si duhet nga Paneli dhe janë marrë parasysh në vendimin e vet të papranueshmërisë.
7. Paneli për më tepër konstaton se po ashtu dokumentet në fjalë nuk kanë pasur ndikim vendimtar në pranueshmërinë e ankesës. Ankesa, e cila lidhet me punën e gjykatave në procedurat gjyqësore në gjykatat e Kosovës, ishte jashtë kompetencave të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë. Paneli nuk ka kompetencë për të vlerësuar as aspektet administrative (p.sh. trajtimin e dokumenteve) e as aspektet gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës (shih në mesin e shumë vendimeve të tjera: *Gani Zeka kundër EULEX-it*, nr. 2012-02; par. 21; *Z kundër EULEX-it*, nr. 2012-06, par. 31).
8. Prandaj ankuesja nuk ka arritur të tregojnë ndonjë dëshmi të re që lidhet me rregullin 42.

PËR KËTO ARSYE,

Refuzon kërkesën e ankueses për rishqyrtim.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese